



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË
KRYETARI

Nr _____ prot

Bulqizë , me ____ . ____ .2024

P/VENDIM

Nr. 01 ,datë 28/05/ 2024

**“PËR RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIKE TË BASHKISË BULQIZË
DHE KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AGJENCISË SË
FUNKSIONEVE TË TRANSFERUESHME NË VARËSI TË BASHKISË BULQIZË”**

Bazuar në **nenin 8, 9** pika 1.1 gërma “c”, pika 1.6 gërma “b”, **nenet 22, 23, 24, 25, 26, 27, 32, 33, nenin 54**, gërma “d”, **nenin 55** pika 2 dhe 6 të ligjit **nr.139/2015** “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), ligjit **Nr.44/2015** “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit **nr. 68/2017** “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit **Nr. 35/2023** “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ligjit **Nr.9220, datë 15.04.2004** “Për Administrimin e Shërbimit të Varrimit” (i ndryshuar), ligjit **57/2020** “Për Pyjet”, ligjit **nr. 9693, datë 19.03.2007** “Për Fondin Kullosor” (i ndryshuar), ligjit **nr. 24/2017** “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, dhe ligjit **nr. 22/2018** “Për Strehimin Social”, Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 503, datë 01.08.2024** “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore ,me propozim të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin Agjencinë e Funksioneve të Transferueshme (AFT) si institucion në varësi të Bashkisë Bulqize .
2. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT) kryen ofrimin e shërbimeve të komunitetit me efçencë, si dhe zbaton planet strategjike të përgatitura në nivel aparati, dhe monitorohet nga kjo e fundit duke patur si qëllim përfundimtar, përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave sipas kërkesave ligjore.

3. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT) ka këto funksione dhe përgjegjësi:

- a) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve që lidhen me shërbimin e pastrimit, menaxhimin e mbetjeve, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit publik, mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe publike, , si dhe mirëmbajtjen e rrugëve në pronësi dhe/ose në administrim të Bashkisë Bulqizë.
4. Drejtori i Agjencisë, emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e agjencisë. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit dhe punonjësve të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
5. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme, do të financohet nga buxheti i Bashkisë Bulqizë , donacione apo burime të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Agjencia mund të krijojë të ardhura nga veprimtaritë e saj sipas përcaktimeve ligjore.
6. Niveli i pagave për punonjësit e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT) do të jetë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 503 , datë 1.8.2024** *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.*
7. ***Struktura e A.F.T do të miratohet në Këshillin Bashkiak me numer të përgjithshëm të punonjësve shoqeruar me nivelin e pages.***
8. Stema dhe vula zyrtare e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT)
 - AFT-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen me urdhër nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë. Stema përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Bashkia Bulqizë , Agjencia e Funksioneve të Transferueshme”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave *“Për mënyrën e përdorimit të Stemës së Republikës si dhe raportin e përmasave të saj”*.
 - Vula zyrtare e AFT-së ka formën dhe elementët e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr.390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, *“Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”*, të ndryshuar. Vula e AFT-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi fillojnë pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore .
10. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni.




11. Bashkia Bulqizë i siguron Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme mjediset e nevojshme, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambienteve të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së saj. Adresa fillestare e agjencisë është ajo e ish-Ndërmarrjes së Shërbimeve Bashkiake Bulqizë .
12. Në rastin e sigurimit të pasurive në administrim të Bashkisë Bulqizë, ngarkohet Zv/ Kryetari i Bashkisë për ndjekjen e procedurave të dorëzimit dhe kalimit kapital të pasurive, objekt i ushtrimit të detyrave funksionale, sipas të këtij vendimi dhe akteve të dala në zbatim të tij.
13. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike e Drejtoria e Finances koordinojnë dhe ndjekin procesin e ngritjes dhe funksionimit të Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme dhe paraqesin pranë kryetarit të bashkisë propozimet përkatëse në lidhje me ristrukturimin e drejtorive ekzistuese për atë sa kompetencat e tyre bien ndesh me ato të agjencisë.
14. Ngarkohen Zv/ Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike , Drejtoria e Finances për zbatimin e këtij vendimi.
15. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(i ndryshuar), dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Dibër.

Drejtoria e MBNj&Juridike
Korab KIKA

Drejtoria Finances
Rustem BIÇI

KRYETARI
Festime MJESHTRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË
KRYETARI

Nr _____ prot

Bulqizë , më 20 . 09 . 2024

RELACION

“PËR RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIKE TË BASHKISË BULQIZË DHE KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AGJENCISË SË FUNKSIONEVE TË TRANSFERUESHME NË VARËSI TË BASHKISË BULQIZË”

Me qëllim përmirësimin e ushtrimit të funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve më me efikasitet dhe efektivitet nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, me iniciativën e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe pas konsultimeve në tryeza të përbashkëta me kryetarët e bashkive sipas grupimeve përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, është arritur dakortësia për implementimin e një riorganizimi të strukturave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore e krijuar me VKM nr 227 datë 09-04-2024, në kuadër të këtij riorganizimi, për t’u ardhur në ndihmë bashkive, ka ofruar për çdo grupim të njësive të qeverisjes vendore (në rastin tonë grupimi I dhe II 0- 50,000 banorë) një Manual, ***i cili është një dokument që prezanton në nivel parimor “kornizën” organike se si bashkitë që i përkasin të njëjtit grupim, të mund të organizohen në mënyrë të përafërt.***

Pas konsultimit me këtë Manual nga ana e strukturave përkatëse të bashkisë Bulqizë, duke qenë se ai përmbante një propozim për organizimin dhe strukturimin e bashkisë ***në përputhje me funksionet që u atribuohen njësive të vetëqeverisjes vendore, dhe se grupimi i funksioneve ishte kryer në 2 tipologji, në ato të patransferueshme, dhe ato të transferueshme/ kontraktueshme, u vendos që të propozohet krijimi i Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT)*** në përputhje me rekomandimet e përshkruara në këtë Manual në lidhje me formën organizative të krijimit të strukturës së funksioneve të transferueshme.

Duke qenë se, Bashkia Bulqizë ka të krijuar ne Struktura organike te saj Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mirëmbajtjes së rrugëve rurale dhe Mjeteve të transportit **ku referuar strukturës në fuqi, rezulton se në 65 % të funksioneve të saj, përputhen me funksionet e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT) që kërkohet të krijohet,** ku funksione shtesë i bashkëngjiten në ***mirëmbajtjen e Pastrim-Gjelbrimit dhe menaxhimin e mbetjeve të Bashkisë Bulqizë*** , strukturat përkatëse pranë Bashkisë Bulqizë, kanë propozuar riorganizimin e Ndërmarrjes aktuale, në krijimin e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT).



Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT) do të jetë një institucion në varësi të bashkisë Bulqizë e cila do të kryejë ofrimin e shërbimeve të komunitetit me efikasitet, si dhe zbaton planet strategjike të përgaditura në nivel aparatit, dhe monitorohet nga kjo e fundit duke patur si qëllim përfundimtar, përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave sipas kërkesave ligjore.

Në Projekt-vendimin e paraqitur për miratim, për krijimin e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT) kemi paraqitur:

1. Funksionet dhe përgjegjësitë që ka Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT);
2. Mënyrën e financimit të AFT-së;
3. Numrin e përgjithshëm, mënyrën e emërimit të drejtorit dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës;
4. Bazueshmërinë për nivelin e pagave;
5. Përcaktimin e stemës, logos dhe vulës zyrtare të AFT-së;
6. Organin kompetent për miratimin e strukturës organizative dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm të Agjencisë;
7. Adresën fillestare dhe strukturat përkatëse që do të ndjekin procesin e ngritjes dhe funksionimit të AFT-së.

Krijimi dhe funksionimi i Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT) si institucion në varësi të Bashkisë Bulqizë për kryerjen e funksioneve që i atribuohen njësisë së vetëqeverisjes vendore, **në bazë të parashikimeve të ligjit organik nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar) është në kompetencë të vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastin konkret bashkisë Bulqizë, nga organet e saj ekzekutive dhe përfaqësuese sipas kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, ku më hollësisht në dispozitat ligjore të ligjit organik nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë:**

Në **Kreun III “Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore” nenin 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”** parashikohet se:

“1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.

2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave.”

Në **nenin 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”** parashikohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetë-qeverisjes, sipas së cilës:... c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;

1.6. Të drejtën e personit juridik:

Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:... b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;



2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e sipër-përmendura ushtrohen nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi.”

Në **nenin 22** “Parimet për ushtrimin e funksioneve” parashikohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi...”

Në **nenin 32** “Administrimi i shërbimeve publike” të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), në të cilin përcaktohet se, citojmë:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë.

2. Mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.”


Në **nenin 33** “Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike” përcaktohet se, citojmë:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:... b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;...”

Në **nenin 54** “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma “d” përcaktohet se, citojmë:

“Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:... d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;...”

Për sa më lart, bazuar në parashikimet e **nenit 8, 9** pika 1.1 gërma “c”, pika 1.6 gërma “b”, **nenet 22, 23, 24, 25, 26, 27, 32, 33**, **nenin 54**, gërma “d”, **nenin 55** pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(i ndryshuar), ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit Nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ligjit Nr.9220, datë 15.04.2004 “Për Administrimin e Shërbimit të Varrimit” (i ndryshuar), ligjit 57/2020 “Për Pyjet”, ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” (i ndryshuar), ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, dhe ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të nëpunësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, kërkohet:

- 
1. ~~Te miratojë~~ krijim e Agjencinë e Funksioneve të Transferueshme (AFT) si institucion në varësi të Bashkisë Bulqize .
 2. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT) kryen ofrimin e shërbimeve të komunitetit me efikasitet, si dhe zbaton planet strategjike të përgatitura në nivel aparat, dhe monitorohet nga kjo e fundit duke patur si qëllim përfundimtar, përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave sipas kërkesave ligjore.
 3. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme (AFT) ka këto funksione dhe përgjegjësi:
 - a) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve që lidhen me shërbimin e pastrimit, menaxhimin e mbetjeve, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit publik, mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe publike, , si dhe mirëmbajtjen e rrugëve në pronësi dhe/ose në administrim të Bashkisë Bulqizë.
 4. Drejtori i Agjencisë, emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e agjencisë. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit dhe punonjësve të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
 5. Agjencia e Funksioneve të Transferueshme, do të financohet nga buxheti i Bashkisë Bulqizë , donacione apo burime të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Agjencia mund të krijojë të ardhura nga veprimtaritë e saj sipas përcaktimeve ligjore.
 6. Niveli i pagave për punonjësit e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT) do të jetë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 503 , datë 1.08.2024** *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.*
 7. ***Struktura e A.F.T do të miratohet në Këshillin Bashkiak me numer të përgjithshëm të punonjësve shoqeruar me nivelin e pages.***
 8. Stema dhe vula zyrtare e Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme (AFT)
 - AFT-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen me urdhër nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë. Stema përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë me shënime: “Republika e Shqipërisë, Bashkia Bulqizë , Agjencia e Funksioneve të Transferueshme”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave *“Për mënyrën e përdorimit të Stemës së Republikës si dhe raportin e përmasave të saj”*.
 - Vula zyrtare e AFT-së ka formën dhe elementët e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr.390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, *“Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”*, të ndryshuar. Vula e AFT-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi fillojnë pas perfundimit të të gjitha procedurave ligjore .
10. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni.
11. Bashkia Bulqizë i siguron Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme mjediset e nevojshme, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambienteve të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së saj. Adresa fillestare e agjencisë është ajo e ish-Ndërmarrjes së Shërbimeve Bashkiake Bulqizë .
12. Në rastin e sigurimit të pasurive në administrim të Bashkisë Bulqizë, ngarkohet Zv/ Kryetari i Bashkisë për ndjekjen e procedurave të dorëzimit dhe kalimit kapital të pasurive, objekt i ushtrimit të detyrave funksionale, sipas të këtij vendimi dhe akteve të dala në zbatim të tij.
13. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike e Drejtoria e Finances koordinojnë dhe ndjekin procesin e ngritjes dhe funksionimit të Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme dhe paraqesin pranë kryetarit të bashkisë propozimet përkatëse në lidhje me ristrukturimin e drejtorive ekzistuese për atë sa kompetencat e tyre bien ndesh me ato të agjencisë.
14. Ngarkohen Zv/ Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike , Drejtoria e Finances për zbatimin e këtij vendimi.
15. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(i ndryshuar), dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Dibër.


Drejtoria e MBNj&Juridike

Korab KIKA



Drejtoria Finances

Rustem BIÇI



KRYETARI
Festime MJESHTRI

